

AKT- THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“B-IdealGroup” Sh.p.k.

Unë, Vladimir Lleshaj, i biri i Vlashit dhe i Dilës, lindur më 08.04.1978 në Prosek, Mirditë, Shqipëri, dhe me banim në Tiranë, në adresën rruga “Hysen Çino”, Nd:27, H.1, Njësia Administrative Nr.2;1010, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. Pers H80408150T, lëshuar më datë 29.10.2019;

Në bazë të legjislacionit shqiptar kam vodosur me vullnetin tim të lirë dh të plotë, të themelojë shoqërinë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; i ndryshuar; ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar , si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijojnë:

Neni 1
Emri, Forma

- 1.1 Shoqëria do të ketë emrin tregtar “ **B-IdealGroup** ” shpk dhe formë ligjore: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “SHPK” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2
Selia

- 2.1 Shoqëria e ka selinë në adresën: Tiranë. Rr Dervish Hima ,Nr pasurie 6/369-N5 Zona Kadastrale 8160 perballë Ambasades Amerikane

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

- 3.1 Objekti i veprimtarisë të shoqërisë do të jetë:

- *Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve me pakicë si: Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial; Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore; Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtorale; Tregëtim fruta – perime; Tregëtim pije alkolike të ndryshme; Tregëtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe fëmijë; Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike; Tregëtim mallrash të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit; Tregëtim automjetesh të cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to; Tregëtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyrash etj; Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative; Tregëtimin e karburanteve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për*



ngrohje, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave të gazit dhe tregëtimin e tyre me pakicë; Tregëtimin e artikujve të ndryshëm kancelarik, libra, revista:

- *Shërbime dhe konsulencë financiare, ndërmjetësimi, tregtare, fiskale, studime tregu, fizibiliteti, hartimi i planeve të biznesit, krijimi i zyrave të përfaqesisë për brande dhe marka të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, shërbime marketingu, shërbime imobiliare, blerje dhe shitje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, marrja dhe dhenia me qera e objekteve të të treteve, përfaqesime tregëtare për biznese vendase dhe të huaja;*
- *Çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitetë të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e kriuar në bazë të legjislacionit Shqiptar.*

Për realizimin e objektit të veprimtarisë shoqëria mund:

- *Të lidhë kontrata me klientët qoftë person fizik ose juridik, Shqiptarë apo të huaj.*
- *Të themelojë partneritete për kryerjen e shërbimeve si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.*
- *Të marrë pjesë me aksione/kuota edhe në shoqëri të tjera vendase, të huaja ose me kapital të përbashkët që kanë objekt shoqëror dhe aktivitet të ngjashëm me të.*
- *Të krijojë filiale dhe zyra përfaqësie në qytete të tjera të Shqipërisë ose në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e tyre.*

3.2. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund :

- (i) *të kryejë çdo aktivitet tregtar, finanziar, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotëkore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;*
 - (ii) *të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi.*
- 3.3. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.
- 3.4. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.
- 3.5. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në Statut.

Neni 4 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 5



Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërise është **150.000.000 (Njëqind e pesëdhjetë milion)** lekë, i cili zotërohet nga ortaku i vetëm si më poshtë:

Emri	Kuota	Përqindja	Kontributi në lekë
VLADIMIR LLESHAJ	1	100%	150.000.000

Neni 6 Administratori

6.1 Administratori i shoqërisë do të jetë Z. **Vladimir Vlash LLESHAJ**, për një afat pesëvjecar, me të drejtë riemërimi

Neni 7 Dispozita e fundit

7.1 Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqipëtar.

Ky Akt-themelimi është përpiluar në dy kopje origjinale.

Tiranë, Datë 16/05/2023

ORTAKU THEMELUES

VLADIMIR LLESHAJ
Vladimir Llesha
